



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit të Komunës  
02/Zyrtarisht  
Datë: 12.03.2024

Bazuar në nenin 58, pika (m), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publikë të OJQ-ve, Rregulloren për ndarje të Subvencioneve Nr. 01/24729, datë: 12.08.20156, të Komunës së Deçanit dhe neni 56, pika 18, të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës bënë:

## Thirrje Publike

(Subvencionim të OJQ-ve dhe Klubeve Sportive)

Komuna e Deçanit, bene thirrje publike të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Deçanit, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në aktivitetet kulturore dhe sportive të komunës së Deçanit.

Përparësi kanë aktivitetet si


1. Festivali “Eshke e ndezur mbi Shkelzen”;
2. 5 dhe 6 Maj “Ditët e Dëshmoreve të Komunës së Deçanit”;
3. Dita e Çlirimit;
4. Panairi Veror;
5. Panairi i Gështenjës.

Përparësi kanë OJQ-të që kanë përvojë në organizimin e aktiviteteve të cekura

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 80,000 (tetëdhjetëmijë) euro.

### Kriteret për aplikim:

- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës, së paku 1 (një) vit para datës së publikimit të thirrjes publike.



- OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të kulturës, traditave të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë.
- OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.
- Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të bashkangjitur në thirrje
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: Ndërtesa e komunës së Deçanit, rruga “Jashar Salihu”, Nr. 3 , kati përdhese, në Zyrën Pritëse.
- Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
- Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune duke filluar nga data: 12.03.2024 deri me 26.03.2024

#### **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim ;**

1. Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së;
2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së, obligative;
3. Certifikatën e regjistrimit obligative;
4. Vërtetim nga ATK, që OJQ nuk ka obligime tatimore-obligative dhe
5. Dëshmi e organizimit të aktiviteteve të ngjashme.

Kryetari i Komunës

Bashkim Ramosaj

